
**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MUÇILAW” Sh.p.k.**

AKT THEMELIMI “MUÇILAW” Sh.p.k.

Pag. 1 a 4



**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR
“MUÇILAW” Sh.p.k.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi tekufizuar “**MUÇILAW**” Sh.p.k. dhe zoterohet nga ortaku:

- 1. Besnik Muçi** atesia, Meleq, shtetas shqiptar, lindur me 18/01/1973 ne Pogradec, banues ne Tirane, identifikuar nepermjet kartes se identitetit Nr. **H30118041B**.

Në përputhje me vullnetin e tij te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendos të hartojnë këtë akt themeli të shoqërisë “**MUÇILAW**” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise eshte “**MUÇILAW**” Sh.p.k.

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionoje në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacioninshqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

**NENI 3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: TIRANE Zona Kadastrale 8150, Rruga "Presidenti G. W. Bush", pallati nr. 1, kati 3, nr. 15 Njesia bashkiake Nr.2. Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4 KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakeve ose kur ka prishje të hershme për arsyet e parashikuara nga ligji.

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “**MUÇILAW**” Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqerie dhe ka si objekt të veprimtarise së saj:

5.1 Sherbime juridike dhe avokatie.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 Leke (njeqindmije), i ndare në 1(nje) pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

Besnik Muçi	100 % - 100.000 LEKE
--------------------	-----------------------------

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne një llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7 AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortaku i shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të janë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Si rezultat i ndryshimeve që mund t'i ndodhin kompanisë në të ardhmen dhe rritjes së numrit të ortakeve, tanjore me vone, trupi që mban kapitalin aksionar të kompanisë do t'i referohet termi “Asamblea e Ortakeve”.

Shoqeria mund te percaktoje me shume se nje Administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "**MUÇILAW**" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër Asambleja e Ortakëve mund të krijojeedhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator i shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emeruar Z. Besnik Muçi, identifikuar nga Karta Identitetit Nr. H30118041B.

NENI 9 DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjkimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 2 (dy) kopje, duke patur secili kopje fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 03 / 02 / 2023

ASAMBLEJA E ORTAKËVE TE SHOQERISE "MUÇILAW" Sh.p.k.

Besnik Muçi